



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.7

3 shkurt

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ nr.1, datë 26.1.2011	Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të zhvillojë procedurën e prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, për objektet e mbrojtjes nga përmytja dhe të kullimit në zonën e Shkodrës e të Lezhës, të planifikuara në buxhetin e vitit 2011.....	145
Vendim i KM nr.24, datë 19.1.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”.....	145
Vendim i KM nr.27, datë 12.1.2011	Për kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten e për masën e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2011.....	146
Vendim i KM nr.32, datë 19.1.2011	Për një shtesë në vendimin nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar.....	148
Vendim i KM nr.33, datë 19.1.2011	Për miratimin e rregullores “Për procedurën e shqyrtimit, nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura” dhe për një ndryshim në vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”.....	149
Vendim i KM nr.34, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar.....	157
Vendim i KM nr.35, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar.....	158

Vendim i KM nr.36, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar.....	158
Vendim i KM nr.37, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	159
Vendim i KM nr.38, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.869, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit””, të ndryshuar.....	159
Vendim i KM nr.39, datë 19.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.78, datë 7.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, të ndryshuar.....	160
Vendim i KM nr.43, datë 19.1.2011	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e Sekretariatit të konventës së bashkëpunimit policor të Europës Juglindore.....	160
Vendim i KM nr.44, datë 19.1.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Xhafzotaj të qarkut të Durrësit.....	162
Vendim i KM nr.45, datë 19.1.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Synej të qarkut të Tiranës.....	163
Vendim i KM nr.46, datë 19.1.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Potom të qarkut të Beratit.....	164
Vendim i KM nr.48, datë 19.1.2011	Për përcaktimin e autoriteteve dhe të përgjegjësive për menaxhimin e decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian në kuadër të IPA-së, komponenti II: bashkëpunimi ndërkufitar.....	165
Vendim i KM nr.53, datë 26.1.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.....	168
Kërkesë e MPPT nr.127/1, datë 18.1.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga dublimi i segmentit rrugor “Fushë-Krujë-Milot”, si dhe nga rrugët dytësore.....	169
Kërkesë e MPPT nr.138/1, datë 18.1.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Kashar - Rinas”.....	174
Kërkesë e MPPT nr.502, datë 26.1.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Himarë e Vjetër-Potam (shtesa)”.....	176
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Alket Latollari.....	177
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Maksim Likaj.....	177

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 26.1.2011

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT TË ZHVILLOJË PROCEDURËN E PROKURIMIT ME NEGOCIM, PA
SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT, PËR OBJEKTET E MBROJTJES NGA
PËRMBYTJA DHE TË KULLIMIT NË ZONËN E SHKODRËS E TË LEZHËS, TË
PLANIFIKUARA NË BUXHETIN E VITIT 2011**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, që për financimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2011, për objektet e mbrojtjes nga përmbytja dhe të kullimit, në zonat e Shkodrës e të Lezhës, të prekura nga përmbytja, të përdorë procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Neni 2

Lista e objekteve, që do të prokurohen sipas nenit 1, të jepet me hollësi nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas përfundimit të projekteve të zbatimit.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.24, datë 19.1.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 5 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja e parë e pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Buxheti për shërbimet spitalore, për vitin 2011, jepet me hollësi, sipas shtojcës 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Spitalet dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor janë të detyruara të llogarisin koston e çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë, brenda 6- muorit të parë të vitit 2011.”.

c) Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve, për vitin 2011, të jetë i pandryshuar, krahasuar me vitin 2010.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.27, datë 12.1.2011

PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN E PËR MASËN E PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2011, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

II. Sektorët, që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

1. Prodhimi i frutave, ullinjve dhe rrushit;
2. Prodhimi i perimeve në serra;
3. Prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit;
4. Prodhimi i produkteve bio;
5. Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë;
6. Mbarështimi i njëhundra të njëve në sektorin e lepurit.

III. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë për:

1. Mbjellje ullishtesh, përjashtuar zonat malore 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale;

2. Mbjellje arrash, bajamesh, lajthish dhe shegësh, përjashtuar zonat malore, 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;

3. Mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkash, ftonjsh, përjashtuar zonat malore, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format intensive të kultivimit, dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për format tradicionale;

4. Agrume, kivi, banane dhe luleshtrydhe, përjashtuar zonat malore 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format intensive të kultivimit, dhe 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për format tradicionale;

5. Mbjelljen e vreshtave, përjashtuar zonat malore, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara sipas masave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

6. Prodhimin e vajit të ullirit ekstra i virgjër, 100 (njëqind) lekë/litër për sasi të deri në 15 tonë/vit.

7. Ujitjen me pika në pemëtoret, agrumishtet, ullishtet (intensive) ekzistuese dhe mbjelljet e reja, si dhe në vreshtat e serrat me ngrohje diellore e teknike, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

8. Prodhimin e produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara, 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë.

9. Blerjen e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

10. Pagesën me 10 (dhjetë) lekë/litër qumësht për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara të racave të pastra apo kryqëzimet e tyre, por jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruara në organet tatimore.

11. Pagesën me 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë, për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë njëhundra krerë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) krerë.

12. Pagesën me 300 (treqind) lekë/krerë dele dhe dhi të matrikulluara për fermerët, përjashtuar ata në zonat malore, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë.

13. Pagesën me 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/fermë mbarështim lepurit, për ferma me jo më pak se 100 (njëqind) krerë.

14. Pagesën me 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere blete.

15. Mbështetjen, përmes subvencionit, në masën 70 (shtatëdhjetë) % të normës së interesit, për 5 (pesë) vite radhazi, për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, që do të merren për:

a) veprimtaritë e ruajtjes, të përpunimit e të grumbullimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të kërpuhës;

b) mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin;

c) peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore.

16. Krijimin e fondit të garancisë për kreditimin e veprimtarisë bujqësore të agroindustrisë, si dhe të atyre të orientuara për eksport, për kreditë në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së principialit të kredisë. Garancia bëhet për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

IV. Masat mbështetëse me kritere lehtësuese për zonat malore e më pak të avantazuara të jenë për:

1. Mbjellje arrash, bajamesh, lajthish dhe shegësh, 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

2. Mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkash, ftonjsh, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për format intensive të kultivimit dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për format tradicionale.

3. Mbjelljen e vreshtave, 300 000 (treqind mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara sipas masave 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 1 (një) dynym.

4. Grumbullimin e gështenjës, 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave të shitura me faturë tatimore.

5. Pagesën me 300 (treqind) lekë/krerë dele dhe dhi të matrikulluara, për fermerët që mbarështojnë jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë.

V. Për informim mediatic të publikut lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të përdoren nga ky fond, për vitin 2011, 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

VI. Përcaktimi i kriterëve për zonat malore e më pak të avantazuara bëhet në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

VII. Kriteret, procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

VIII. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.32, datë 19.1.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA E SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 20.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, për vitin 2011, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si autoritet kontraktor, të realizojë vetë procedurat e prokurimit për shërbimin e uniformës së Policisë së Shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.33, datë 19.1.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT, NGA KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK, TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË ANKANDIT APO VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1719, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 42/1, pika 3, dhe 45 të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për procedurën e shqyrtimit, nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 8.1 e kreut VIII, në tekstin që i bashkëlidhet vendimit nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT NGA KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK, TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË ANKANDIT APO VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga to, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “Komisioni” është Komisioni i Prokurimit Publik;
b) “Ligji 9874/2008” është ligji nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;

c) “Rregullorja e Komisionit të Prokurimit Publik” është rregullorja e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.184, datë 17.3.2010 “Për miratimin e rregullore “Për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.659, datë 3.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike””.

Neni 3

Parimet e veprimitarisë

Në veprimtarinë e tij në kuadër të shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga to, Komisioni respekton parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit;
- c) pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- ç) shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme;
- d) transparencës dhe informimit të publikut; dhe
- dh) mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit shtetëror dhe tregtar.

Neni 4

Organizimi dhe funksionimi i Komisionit

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit janë të njëjtat me ato të parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik.

KREU II

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Neni 5

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale kryhen në përputhje me ligjin 9874/2008.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Komisioni cakton afate prekluzive, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6

E drejta e ankimit

1. Të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Komisionit e ka çdo ofertues që ka paraqitur përpara autoritetit shitës ankesën për një procedurë ankandi kur autoriteti shitës:
 - a) nuk ka shqyrtuar ankesën brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës;
 - b) ka refuzuar ankesën; ose
 - c) ka vendosur mospranimin e ankesës.
2. Të drejtën për të paraqitur ankesë pranë Komisionit e ka edhe çdo ofertues që është përjashtuar nga procedurat e ankandit.
3. Ankesa i paraqitet komisionit brenda 7 ditëve në rrugë elektronike, përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi. Ky afat, në varësi të shkakut të ankesës, fillon:
 - a) nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit brenda të cilit autoriteti shitës duhet ta kishte shqyrtuar ankesën;
 - b) nga dita e njoftimit të refuzimit të ankesës nga autoriteti shitës;
 - c) nga dita e marrjes së njoftimit për përjashtimin nga procedurat e ankandit; ose
 - d) nga dita kur ankimuesi ka marrë njoftimin e mospranimit nga autoriteti shitës.

4. Ankimesi i dërgon një kopje të ankesës së paraqitur në komision njëkohësisht autoritetit shitës, në rrugë elektronike përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e ankesës

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit 1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

- a) të dhënat identifikuese të ankimesit;
- b) adresën e ankimesit;
- c) referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;
- ç) bazën ligjore;
- d) një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- dh) pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
- e) shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit shitës;

ë) dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

- a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;
- b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;
- c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

Neni 8

Regjistrimi i ankesës

1. Ankesat i paraqiten Komisionit në mënyrë elektronike dhe regjistrohen menjëherë. Komisioni mban një regjistër të posaçëm elektronik për regjistrimin e ankesave, i cili publikohet në faqen zyrtare.

2. Komisioni nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e ankesave.

3. Përmbajtja, formati i standardizuar i regjistrimit dhe rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe administrimit të ankesave, janë të njëjta me ato të parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 9

Afatit për vendimmarrjen

1. Komisioni merr vendim mbi ankesën brenda 7 ditëve kalendarike nga regjistrimi i saj.

2. Për arsye të motivuara, Komisioni vendos zgjatjen e afatit të mësipërm, por jo më shumë se 20 ditë nga regjistrimi i ankesës.

3. Komisioni ia njofton vendimin për zgjatjen e afatit palëve, në formë elektronike brenda 3 ditëve nga marrja e tij.

Neni 10

Rregulla të përgjithshme procedurale

Për caktimin e çështjeve, njohjen me aktet, përjashtimin e anëtarëve të Komisionit, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur në rast konflikti i interesit, si dhe pjesëmarrjen dhe detyrat e inspektorëve në procedurën e shqyrtimit të ankesave sipas ligjit 9874/2008, zbatohen rregullat e parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 11

Verifikimi i kushteve formale

1. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 3 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

- a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;
- b) legjitimitimin e ankuesit;
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d) elementet e domosdoshme të ankesës së parashikuar në nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje.

2. Relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe nëse autoriteti shitës e ka pezulluar procedurën e ankandit, ai i relaton Komisionit rezultatet e verifikimit.

3. Komisioni voton sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik për votimin, duke vendosur:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimuesit brenda 3 ditëve, duke i treguar edhe të drejtën për t'u ankuar në gjykatë. Vendimi i njoftohet edhe autoritetit shitës, me qëllim që ky i fundit të marrë masat për vazhdimin e procedurës së ankandit nëse e ka pezulluar atë.

b) Kalimin e ankesës për shqyrtim, duke marrë një prej vendimeve të parashikuara në nenin 15 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, me kërkesë të relatorit të bazuar në aktet e bashkëlidhura ankesës, Komisioni vendos edhe nëse duhet marrë mendimi i specialistëve/ekspertëve të pavarur, si dhe njofton ankuesin për afatin e parapagimit të ekspertëve. Njoftimi përmban edhe paralajmërimin se në rast të mosparapagimit të ekspertizës në afatin e caktuar, Komisioni nuk thërret dhe nuk merr si provë ekspertizën e kërkuar.

Neni 12

Urdhrat e ndërmjetëm

Komisioni, kur vendos kalimin e ankesës për shqyrtim në themel, mund të urdhërojë:

a) pezullimin e procedurës së ankandit në rast se autoriteti shitës nuk e ka pezulluar atë me marrjen njoftim për ankesën;

b) vazhdimin e procedurës së ankandit nga autoriteti shitës nëse çmon se pezullimi i procedurës së ankandit dëmton interesin publik, autoritetin shitës ose ofertuesit ose ka të dhëna se ankimuesi nuk do të ketë sukses me ankesën.

Neni 13

Shqyrtimi në themel

1. Nëse kërkesa përmbush elementet formale, Komisioni vazhdon me shqyrtimin në themel të saj brenda së njëjtës mbledhjeje. Nëse vazhdimi nuk është i mundur, sepse nevojitet marrja e një prove të caktuar, mbledhja e radhës zhvillohet brenda 7 ditëve nga regjistrimi i ankesës. Në raste të ndërlikuara, Komisioni vendos zgjatjen e afatit të mësipërm, por jo më shumë se 20 ditë nga regjistrimi i ankesës.

2. Komisioni vendos mbi një ankesë në mbledhje me dyer të mbyllura.

3. Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbal, i cili përmban edhe rezultatet e votimit të anëtarëve. Procesverbali nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje.

Neni 14

Të drejtat e Komisionit gjatë fazës së shqyrtimit në themel

1. Komisioni ka të drejtë të kërkojë të dhëna dhe shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ.

2. Komisioni ka të drejtë t'u kërkojë palëve dokumentacion apo të dhëna në mbështetje të pretendimeve të tyre, të marrë në pyetje çdo person që çmon se është i lidhur me procedurën e rishikimit, si dhe të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.

3. Për përgjigjet ndaj kërkesave dhe dorëzimit të dokumenteve sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Komisioni ka të drejtë të caktojë afate, në përputhje me legjislacionin që rregullon procedurat administrative.

Neni 15

Procedura të veçanta

Në rastin e ankesave ndaj vendimeve përfundimtare të autoritetit shitës mbi sqarimet për dokumentet e ankandit, Komisioni e trajton atë sipas rregullave të ankimit administrativ të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 16

Kufijtë e shqyrtimit të ankesës

1. Komisioni shqyrtton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit shitës gjatë procedurës së ankandit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.

Neni 17

Vendimi i Komisionit

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës, vendos me akt të motivuar:

a) pushimin e gjykimit administrativ për shkak se veprimet e treguara në ankesë nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit mbi ankandin publik ose të dispozitave administrative apo penale apo kur pretendimet e ankuesit rezultojnë të paprovuara; ose

b) ndalimin e autoritetit shitës të përfshirë të vazhdojë veprimet e jashtëligjshme, duke i caktuar një afat kohor.

2. Arsyet e pushimit të gjykimit sipas paragrafit 1, shkronja "a" të këtij neni, i njoftohen me shkrim ankimesit.

3. Nëse Komisioni vendos sipas paragrafit 1, shkronja "b", të këtij neni, me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit shitës është në kundërshtim me ligjin 9874/2008 dhe kontrata ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin shitës të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së ankandit;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, vendimin ose veprimin e autoritetit shitës, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së ankandit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;

c) të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin shitës mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së ankandit;

d) të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin shitës për rifillimin e procedurës së ankandit.

4. Nëse Komisioni vendos sipas paragrafit 1, shkronja “b”, të këtij neni, me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit shitës është në kundërshtim me ligjin 9874/2008 dhe kontrata është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin shitës të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së ankandit;

b) Të deklarojë një fakt të caktuar të rezultuar gjatë shqyrtimit administrativ. Ky vendim mund të përdoret në gjykatë si dokument që justifikon dëmshpërblimin gjyqësor të ankuesit për humbjet ose dëmet e pësuar nga shkelja e ligjit;

c) Të marrë masa konkrete ndaj personave përgjegjës në përputhje me dispozitat e ligjit 9874/2008. Këto masa përfshijnë, sipas rastit, këshillimin e të dëmtuarit për të ngritur padi në gjykatë ose për të paraqitur kallëzim penal, si dhe raportimin tek autoriteti përkatës i shkeljes së qëllimshme të ligjit prej zyrtarit të autoritetit shitës. Kur Komisioni gjykon se një punonjës i autoritetit shitës ka kryer një shkelje të qëllimshme që prek parimet dhe qëllimin e ligjit 9874/2008, mund të bëjë kallëzim penal.

Neni 18

Përmbajtja e vendimit

1. Vendimi i Komisionit përmban numrin, datën, nënshkrimin, vulën e Komisionit, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë.

2. Vendimi i Komisionit duhet të arsyetohet.

3. Të gjitha kopjet e vendimit nënshkruhen nga kryetari.

4. Vendimi i njoftohet ankimuesit dhe autoritetit shitës.

5. Autoriteti shitës brenda 10 ditëve nga marrja dijani mund t'i drejtohet Komisionit me kërkesë për rishikimin e vendimit. Rishikimi i vendimit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative.

Neni 19

Shpenzimet procedurale

Rregullat mbi shpenzimet procedurale janë të njëjta me ato të parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 20

Karakterit detyrues i vendimeve të Komisionit

Autoritetet shitëse, nëse brenda 10 ditëve nga marrja dijani nuk kërkojnë pranë Komisionit rishikimin e vendimit të tij, janë të detyruara ta zbatojnë atë në përputhje me urdhërimet e tij.

Neni 21

Arkivimi i dokumentacionit

Në procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga to, Komisioni zbaton, për aq sa është e mundur, rregullat e parashikuara në Rregulloren e Komisionit të Prokurimit Publik, për arkivimin e dokumentacionit.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22
Dispozitë tranzitore

1. Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në gjendjen në të cilën ato ndodhen. Afati për shqyrtimin e tyre fillon nga data e dorëzimit nga Agjencia e Prokurimit Publik te Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave ndaj procedurave të ankandit, të paraqitur pranë tij, përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, për aq sa është e mundur me rregullat e vendosura në këtë rregullore.

ANEKSI NR.1
FORMULARI I ANKESËS DREJTUAR KOMISIONIT

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi postar/Kodi Zip

Nr. telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për procedurën

1. Numër identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose dokumentet standarde të procedurës konkurruese, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për ankandin, kundër të cilit bëhet ankimi (p.sh. procedurë me parakualifikim (me dy faza), procedurë pa parakualifikim).

2. Autoriteti kontraktues

Emri i autoritetit kontraktues që administron procesin e konkurrimit

3. Vlera e përlogaritur e procedurës konkurruese
Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i kontratës
Përshkrim i shkurtër i objektit të kontratës

5. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertës
Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e përcaktimit të kontratës fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore e ankesës

(shkruani shkëlqen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e fakteve dhe argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën, në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumenteve standarde të procedurës konkurruese, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

Seksioni IV. Kundërshtimi paraprak ndaj autoritetit kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar ndaj një vendimi të autoritetit kontraktues.

Bashkëngjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një të tillë.

1. Shkallët e ndjekura të ankimit:

Keni bërë ndonjë ankim për këtë procedurë konkurruese? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (p.sh., me shkrim, nëpërmjet faksit), organin shtetëror dhe llojin e vendimit të dhënë (duke përshkruar edhe nëse organi nuk është shprehur fare për ankimin tuaj).

Po

Jo

Nëse PO, të jepen detajet dhe dokumentacioni përkatës

2. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës së ankimit

3. Pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar

Çfarë vendimi kërkoni të marrë Komisioni?

4. Lista e shtojcave

a) Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkëngjisni një kopje të lexueshme të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjitha këtyre dokumenteve. Dokumentet duhet të përfshijnë normalisht çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentet standarde të procedurës konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën; dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.

b) Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumenteve përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

c) Përcaktoni nëse kërkon përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të Komisionit për konflikt interesi.

d) Përcaktoni nëse kërkon ekspertizë të posaçme për shqyrtimin e ankimit.

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për ankandin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

KUJDES! Një kopje e kësaj ankese duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit kontraktues dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr.fax: e-mail

Nënshkrimi dhe vula e ankuesit

VENDIM

Nr.34, datë 19.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i tretë i pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pagesa e aftësisë së kufizuar, për të verbrit dhe kujdestarët e tyre, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.35, datë 19.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË
MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 19 pika 3, 20 pika 2, 29, pika 10 e 35 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 23/1 e kreut III të vendimit nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23/1. Përfitimi i ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në pikat 18, 19, 20, 21 dhe 22, të këtij vendimi, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.36, datë 19.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 pika 1, e 20 pika 3 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit i pikës 17 të vendimit 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pagesa për personat me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.37, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë i pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pagesa e aftësisë së kufizuar në masën e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.38, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.869, DATË 18.6.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E
INVALIDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.869, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Pagesa e përfitimit të paaftësisë, për invalidin, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.39, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 7.2.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË
PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.78, datë 7.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Pagesa shtesë, që përfitohet sipas pikës 1 të këtij vendimi, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.43, datë 19.1.2011

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIMIN
DHE MBËSHTETJEN E SEKRETARIATIT TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT
POLICOR TË EUROPËS JUGLINDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e sekretariatit të konventës së bashkëpunimit policor të Europës Juglindore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR BASHKËPUNIMIN DHE MBËSHTETJEN LIDHUR ME SEKRETARIATIN E
KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE
TË 21 MAJIT 2010
(CoM 02/10)

Duke rikujtuar konkluzionet e mbledhjes së parë të Komitetit të Ministrave të miratuar më 17 korrik 2008 në Vjenë;

Duke marrë parasysh konsultimet e plotë, si midis palëve kontraktuese dhe me partnerët e tyre kryesorë ndërkombëtarë;

Duke rikonfirmuar angazhimin e plotë të palëve kontraktuese për një proces efektiv implementimi, duke përfshirë caktimin e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore;

Ministrat e palëve kontraktuese të konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore (më poshtë referuar si: “Konventa”) dhe Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (më poshtë referuar si: “DCAF”) kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm lidhur me Sekretariatit e konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore (më poshtë referuar si: “Sekretariati”)

1. Ky memorandum i mirëkuptimit ka për qëllim të përcaktojë:

- rolin dhe detyrat e Sekretariatit;
- bashkëpunimin ndërmjet palëve kontraktuese dhe Sekretariatit;
- mbështetjen e palëve kontraktuese për funksionimin e Sekretariatit; dhe
- modalitetet organizative dhe operative të Sekretariatit.

2. Sekretariati do të veprojë si një organ teknik ekspert me mandatin për të ndihmuar dhe mbështetur palët kontraktuese në zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të konventës.

3. Nën drejtimin politik të Komitetit të Ministrave dhe mbikëqyrjen e grupit të punës të ekspertëve (neni 33, paragrafi 2 i Konventës), Sekretariati do të jetë i mandatar me këto detyra dhe përgjegjësi:

- të kryejë detyrat e përcaktuara nga Komiteti i Ministrave dhe grupi i punës i ekspertëve;
- të koordinojë, harmonizojë dhe regjistrojë të gjitha aktivitetet që lidhen me konventën, duke përfshirë dhe agjendën legjislative të palëve kontraktuese dhe shkëmbimin e praktikave të mira në lidhje me zbatimin kombëtar të dispozitave të konventës;
- të regjistrojë të gjitha marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura në kuadrin e konventës;
- të përgatitë mbledhjet e organeve të parashikuara nga konventa (Komiteti i Ministrave, grupi i punës i ekspertëve) dhe për të koordinuar aktivitetet e të gjitha grupeve të punës;
- të jetë pikë kontakti për koordinimin e palëve kontraktuese dhe partnerëve ndërkombëtarë në lidhje me përfshirjen e tyre në zbatimin e konventës;
- të lehtësojë bashkëpunimin mes palëve kontraktuese dhe partnerëve ndërkombëtarë që ka për qëllim të sigurojë dhënien e ndihmës përkatëse dypalëshe ose shumëpalëshe për zbatimin e konventës;
- të përgatitë një listë ekspertësh me njohuri dhe përvojë në fushat e mbuluara nga/dhe që lidhen me konventën;
- t'i raportojë, mbi funksionet dhe aktivitetet e tij sipas konventës, drejtpërsëdrejti Komitetit të Ministrave, në takime ministeriale ose në mënyrë indirekte, përmes grupit të punës të ekspertëve;
- të mbajë palët kontraktuese “Komitetin e Konventës” dhe publikun të informuar mbi zhvillimet lidhur me konventën; dhe
- të kryejë funksionet e tjera të Sekretariatit.

4. Në punën e tij Sekretariati do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me grupin e punës të ekspertëve dhe me pikat kombëtare të kontaktit të caktuara nga vendet e përkatëse.

5. Sekretariati është i vendosur në Lubjanë, Slloveni, është i lidhur institucionalisht me DCAF dhe do të veprojë jashtë ambienteve të institutit DCAF të Lubjanës. Ai do të administrohet sipas rregullave dhe rregulloreve të DCAF. Pas konsultimeve me palët kontraktuese, kryetari i Sekretariatit do të caktohet nga DCAF.

6. Palët kontraktuese me zgjidhjen e tyre, mund të plotësojnë me staf Sekretariatit. Grupi i punës së ekspertëve dhe kryetari i Sekretariatit, së bashku përgatisin një plan për plotësim me staf, duke përfshirë edhe marrëveshjet që specifikojnë kohëzgjatjen dhe kushtet e tjera të transferimeve individuale.

7. Sekretariati do të përgatitë një raport progresi vjetor për Komitetin e Ministrave. Bashkëlidhur këtij raporti, do të jetë një deklaratë financiare që mbulon menaxhimin e Sekretariatit për financat e tij.

8. Sekretariati do të mbështetet financiarisht nga palët kontraktuese dhe partnerët ndërkombëtarë. Kryetari i Sekretariatit do të përgatitë një buxhet vjetor që do të bihet dakord nga palët kontraktuese dhe partnerët ndërkombëtarë.

Për dy vitet e para, palët kontraktuese bien dakord të kontribuojnë me një shumë vjetore prej 10 000 euro (dhjetë mijë euro) secili, në mënyrë që të ndihmojnë në mbulimin e shpenzimeve operative të Sekretariatit. Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë.

9. Dispozitat e këtij memorandumit i nënshtrohen rishikimit nga palët kontraktuese në çdo kohë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar (nga qeveritë e tyre respektive), kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi:

Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë;

Ministri i Brendshëm i Republikës së Bullgarisë;

Ministri i Sigurisë i Bosnjës dhe Hercegovinës;

Ministri i Brendshëm i Republikës së Maqedonisë;

Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Moldavisë;

Në emër të Ministrit të Brendshëm dhe Administratës Publike të Malit të Zi;

Ministri i Administratës dhe i Brendshëm i Rumanisë;

Ministri i Brendshëm i Republikës së Serbisë;

Drejtori i Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik mbi Forcat e Armatosura.

Nënshkruar në më 2010, në nëntë kopje origjinale në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr.44, datë 19.1.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS XHAFTOTAJ TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Xhafzotaj të qarkut të Durrësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 35 (tridhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 170 (njëqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Xhafzotaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Xhafzotaj		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-21, 153	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
22-31, 154	Varrezat publike	Në pronësi
51	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
32, 44-50	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
102	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
52-59	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
68-73, 75, 76, 78, 79, 83, 86, 87, 91, 95, 99, 100, 155	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive). Prona 155 është tokë arë.	Në pronësi

VENDIM
Nr.45, datë 19.1.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SYNEJ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Synej të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Synej për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lidhja nr.1 Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
11-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
20-38	Varrezat publike	Në pronësi
39-44	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
46-410	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.46, datë 19.1.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS POTOM TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Potom të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Potom të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.411, datë 22.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Potom të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Potom për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-32	Varrezat publike	Në pronësi
34-41	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
44-45, 47-48, 50, 52, 54-55, 57 -58, 60-61, 63-64, 66-68, 70	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (tokë produktive)	Në përdorim
46, 49, 51, 53, 56, 59, 62, 65, 69, 71	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM**Nr.48, datë 19.1.2011**

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE DHE TË PËRGJEGJËSIVE PËR MENAXHIMIN E DECENTRALIZUAR TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN NË KUADRIN E IPA-së, KOMPONENTI II: BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA)”, të ratifikuar me ligjin nr.9840, datë 10.12.2007, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për komponentin II të IPA-së: bashkëpunimi ndërkufitar janë:

1. Autoritetet

1.1 Koordinatori kombëtar i IPA-së (NIPAC)

NIPAC-ja/Ministri i Integritit është përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet ndërkufitare.

1.2 Koordinatori i bashkëpunimit ndërkufitar (BNK)

a) Koordinatori i BNK-së emërohet zëvendësministri i Integritit, me urdhër të brendshëm të NIPAC-së;

b) Koordinatori i BNK-së ka përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar:

i) koherencën dhe koordinimin e programeve ndërkufitare, komponenti II i IPA-së;

ii) koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet ndërkufitare si me shtetet anëtare të BE-së, ashtu edhe me vendet e tjera përfituese, si dhe në programet transnacionale, në kuadër të instrumenteve të komunitetit.

1.3 Drejtuesi i strukturës operuese (DSO)

a) Drejtuesi i strukturës operuese emërohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritit, me urdhër të brendshëm të NIPAC-së;

b) DSO-ja ka këto funksione:

i) Koordinon dhe mbikëqyr funksionimin e njësisë BNK dhe të agjencisë zbatuese, të kryesuar nga zyrtari i programit i autorizuar (ZPA);

ii) Siguron funksionimin e duhur të SO-së dhe raporton te ZKA-ja dhe NIPAC-ja/Ministri i Integritimit.

1.4 Përgjegjësi i njësisë së bashkëpunimit ndërkuftar (PNJBK)

a) Përgjegjësi i sektorit të bashkëpunimit rajonal, në Ministrinë e Integritimit, emërohet përgjegjës i njësisë BNK, me urdhër të brendshëm të Ministrisë të Integritimit;

b) PNJBK-ja ka këto funksione:

i) Merr vendimet operative në lidhje me programimin dhe monitorimin, në nivel programi;

ii) Është përgjegjës për vendimmarrjen e Shqipërisë në lidhje me funksionet e Komitetit të Përbashkët Monitorues (KPM), të përcaktuara në nenin 142 (5) (shkronjat b-d dhe g-h), të rregullores zbatuese IPA;

iii) Garanton kontrollin dhe mbikëqyrjen adekuate të Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në asistimin e strukturës operuese dhe KPM-së në kryerjen e këtyre funksioneve.

1.5 Zyrtari i programit i autorizuar (ZPA)

a) Agjencia zbatuese (DFFK) kryesohet nga zyrtari i programit i autorizuar (ZPA);

b) ZPA-ja ka këto funksione:

i) Është përgjegjës për ligjshmërinë, rregullsinë dhe menaxhimin e shëndoshë financiar të çdo transaksioni zbatimi, kryesisht, të kontratave dhe të pagesave;

ii) Merr vendimin përfundimtar për qëndrimin e vendit përfitues në Komitetin e Përbashkët Monitorues (KPM) pas konsultimit me anëtarët e tjerë të KPM-së nga Shqipëria, dhe konkretisht, me njësinë BNK, për shqyrtimin, miratimin dhe rishikimin e kriterëve për përzgjedhjen e operacioneve që do të financohen nga programet BNK, në zbatim të nenit 142 (5), shkronjat “a” dhe “f”, të rregullores zbatuese IPA;

iii) Ka autoritetin dhe përgjegjësinë të ushtrojë mbikëqyrje të sistemeve që përdoren nga aktorët, sidomos nga SPT-ja, të cilët fillojnë ose verifikojnë transaksione financiare përpara vendimit të tij/saj;

iv) Ka autoritetin dhe përgjegjësinë të përcaktojë modalitetet procedurale sesi do të bëhet mbikëqyrja e sistemeve të lartpërmendura.

1.6 Zyrtari kombëtar i akredituar (ZKA)

a) ZKA-ja është drejtues i fondit kombëtar (FK);

b) ZKA-ja mban përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm financiar të fondeve të Bashkimit Europian në Shqipëri. Ai është përgjegjës për ligjshmërinë, rregullsinë e transaksioneve që lidhen me këto fonde, në përputhje me nenin 25 (2), shkronja “a”, të rregullores zbatuese IPA;

c) ZKA-ja do të ushtrojë të njëjtat kompetenca që përcaktohen në vendimin nr.719, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së, komponenti I”.

2. Strukturat

2.1 Struktura operuese (SO) për zbatimin e komponentit II të IPA-së: bashkëpunimi ndërkuftar

a) SO-ja është përgjegjëse për programimin, menaxhimin dhe zbatimin e programeve BNK, IPA, në përputhje me praktikën më të mira të parimeve të menaxhimit financiar, dhe e kryen funksionin e vet në pajtim me nenin 28 të rregullores zbatuese IPA-së;

b) SO-ja për programet BNK përbëhet nga dy njësi:

i) Njësia BNK;

i/1. Njësia BNK përfaqësohet nga sektori i bashkëpunimit rajonal, në Ministrinë e Integritimit.

i/2. Njësia BNK mban përgjegjësinë për programimin dhe monitorimin, në nivel programi.

ii) Agjencia zbatuese (AZ)

ii/1. Agjencia Zbatuese është Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive në Ministrinë e Financave (DPFK).

ii/2. Agjencia zbatuese (DPFK) është përgjegjëse për zbatimin financiar të programeve të bashkëpunimit ndërkuftar. Ajo ka përgjegjësinë për tenderimin dhe kontraktimin, pagesat, aspektet

e kontabilitetit dhe të raportimit financiar që lidhen me prokurimin e shërbimeve, të mallrave, të punimeve e të granteve për pjesën e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

ii/3. Agjencia zbatuese (DPFK) do të kryejë të gjitha funksionet, siç përcaktohet në vendimin nr.719, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së, komponenti I”.

2.2 Strukturat e përbashkëta të menaxhimit (SPM) për zbatimin e komponentit II të IPA-së: bashkëpunimi ndërkufitar

a) Për çdo program BNK, Shqipëria merr pjesë në strukturën operuese shqiptare dhe strukturën/at operuese pjesëmarrëse në programe BNK që do të ngrenë SPM-të;

b) SPM-të do të mbikëqyrin zbatimin e programit përkatës BNK;

c) Për çdo program BNK, ku Shqipëria merr pjesë, SPM-të do të përbëhen nga dy struktura:

i) Komiteti i Përbashkët Monitorues (KPM)

i/1. KPM-ja e programit përkatës BNK ngrihet bashkërisht nga struktura operuese shqiptare dhe struktura operuese që përfaqëson vendin përfitues pjesëmarrës në programin BNK.

i/2. KPM-ja, bashkë me strukturat operuese, siguron cilësinë e zbatimit të programit përkatës BNK.

i/3. KPM-ja është organi vendimmarrës i programit përkatës BNK.

i/4. KPM-ja përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente kombëtare, rajonale dhe vendore, nga partnerë ekonomikë dhe socialë, si dhe nga çfarëdo organi që përfaqëson shoqërinë civile, në zbatim të nenit 142 (3) dhe të nenit 87, të rregullores zbatuese IPA.

i/5. Përfaqësuesit e strukturës (ave) operuese, që marrin pjesë në programin përkatës BNK, janë anëtarë të KPM-së përkatëse.

i/6. Detyrat e KPM-së parashikohen në nenin 142 të rregullores zbatuese IPA dhe rregullohen me rregullore të brendshme, të miratuar me vendim të tij.

ii) Sekretariati i përbashkët teknik (SPT)

ii/1. Struktura operuese shqiptare dhe struktura operuese pjesëmarrëse në programin përkatës BNK, do të krijojnë një SPT për të asistuar KPM-në përkatëse dhe strukturat operuese në kryerjen e përgjegjësive të tyre.

ii/2. KPM-ja është organi administrativ i programit BNK përgjegjës për menaxhimin e përditshëm.

ii/3. Detyrat e SPT-së rregullohen nga rregullorja e brendshme e tij.

ii/4. Rregullorja e brendshme e SPT-së do të hartohet bashkërisht dhe do të miratohet nga strukturat operuese pjesëmarrëse në programin përkatës BNK.

ii/5. SPT-ja mund të ketë një antenë, të vendosur në secilin shtet pjesëmarrës në programin BNK, e cila ka të njëjtat përgjegjësi dhe funksione si dhe SPT-ja.

ii/6. SPT-ja, bashkë me antenën, menaxhohet bashkërisht nga strukturat operuese pjesëmarrëse në programin përkatës BNK.

2.3 Fondi kombëtar (FK)

a) FK-ja është përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të menaxhimit financiar të asistencës IPA, siç është parashikuar në nenin 26 të rregullores zbatuese IPA.

b) FK-ja është nën përgjegjësinë e ZKA-së, i cili është kryetari i NF-së, në përputhje me nenin 25 (2), shkronja “a”, të rregullores zbatuese IPA.

c) Fondi kombëtar do të kryejë të gjitha funksionet siç përcaktohet në vendimin nr.719, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të IPA-së, komponenti I”.

II. Ndarja e detyrave ndërmjet organeve individuale, që përbëjnë strukturën operuese, do të bëhet me një rregullore të brendshme, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregullat zbatuese të IPA-së. Rregullorja e brendshme do të miratohet nga ZKA-ja, pas konsultimeve me NIPAC-në/Ministrin e Integritimit.

III. Ngarkohen Ministria e Integritit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.53, datë 26.1.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.857, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
PARËSOR NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHYUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, shkronja “b”, e 36, të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shtojcën 2 “Rregullorja e përgjithshme për kontraktimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor”, që i bashkëlidhet vendimit, neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

1. Kontrata rregullon llojet e mëposhtme të pagesave për ofrimin në sasi dhe cilësi të shërbimeve shëndetësore:

a) Pagesa fikse mujore (që këtej e tutje do të quhet pagesa fikse);

b) Pagesa mujore, bazuar në veprimtarinë (që këtej e tutje do të quhet pagesa e bazuar në veprimtarinë);

c) Pagesa bonus tremujore (që këtej e tutje do të quhet bonus).

2. Pagesa fikse është: pagesa për banorë, por gjatë periudhës 2011-2013 do të bazohet në historikun e shpenzimeve. Pagesa fikse llogaritet në masën 80% të historikut të shpenzimeve të QSH-së.

3. Pagesa bazuar në veprimtarinë është: pagesa për numër vizitash dhe shërben për të nxitur rritjen e veprimtarisë së QSH-së. Pagesa bazuar në veprimtarinë llogaritet në masën 10% të fondit të përgjithshëm të kontraktimit, në nivel qarku. Kjo shumë do të shpërndahet për çdo QSH, bazuar në numrin mesatar ditore të vizitave të kryera nga mjekët e kontraktuar.

4. Bonusi është: pagesa për cilësinë dhe shërben për të nxitur angazhimin e mëtejshëm të QSH-së për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe efektivitetin. Bonusi llogaritet në masën 10% të fondit të përgjithshëm të kontraktimit në qark. Kjo shumë do të shpërndahet për çdo QSH, bazuar në realizimin e treguesve përkatës.

5. Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve, për të cilat QSH-ja mund të përfitojë bonus, bëhet në bazë të plotësimit të treguesve që matin:

a) koston e trajtimit të pacientëve;

b) procesin që kryejnë qendrat shëndetësore për kujdesin shëndetësor ndaj pacientëve;

c) rezultatin e kujdesit shëndetësor dhe trajtimit me barna;

ç) pjesëmarrjen e stafit mjekësor në edukimin mjekësor të vazhdueshëm.

Kontrata duhet të përcaktojë qartë kur QSH-ja gëzon të drejtën e marrjes së pagesës bonus.”.

2. Aneksi “a”, që i bashkëlidhet shtojcës 2, shfuqizohet dhe kudo në vendim dhe në rregullore hiqen referencat në aneksin “a”.

3. Aneksi “b”, që i bashkëlidhet shtojcës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Aneksi b

TREGUESIT PËR VLERËSIMIN E CILËSISË

1. Shërbimet ofrohen në nivel mjekësor dhe profesional më të lartë të mundshëm, të matura përmes:

A)përqindjes së pacientëve të regjistruar që janë vizituar për herë të parë nga personeli shëndetësor gjatë vitit;

b) kostos mesatare të recetave për diagnozë, për 4 (katër) diagnoza të zgjedhura;

c) përqindjes së pacientëve kronikë, të vizituar çdo muaj nga MPF-ja;

ç) përqindjes së grave shtatëzëna që marrin vizitën e parë të detyrueshme nga personeli shëndetësor, brenda tremujorit të parë;

d) përqindjes së fëmijëve të moshës 0-1 vjeç, që kanë kryer vizitat e detyrueshme nga personeli shëndetësor;

dh) përqindjes së fëmijëve të moshës 0-14 vjeç, të vaksinuar gjatë 3-mujorit;

e) përqindjes së pacientëve me hipertension arterial, të diagnostikuar nën mjekim (të gjitha stadet) që kanë vlerën e tensionit arterial brenda “normës”;

ë) përqindjes së pacientëve me diabetin melitus, të diagnostikuar nën mjekim, që kanë nivelin e glicemisë esëll/hemoglobinës së glukozuar në “normë”;

f) përqindjes së stafit që merr kreditet e kërkuara në kuadrin e edukimit mjekësor të vazhdueshëm.

2. Në kontratë do të përcaktohen hollësisht rastet kur qendra shëndetësore gëzon të drejtën e marrjes së pagesës bonus.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

Nr.127/1, datë 18.1.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga dublimi i segmentit rrugor “Fushë-Krujë-Milot”, si dhe nga rrugët dytësore.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për pasurinë në proces regjistrimi, pronari përkatës do të kompensohet për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

Për pasurinë në proces saktësimi, pronari përkatës do të kompensohet për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

Për pasurinë me barrë hipotekore, pronari përkatës do të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të konfirmohet nga ZVRPP-ja, që kjo pasuri është e lirë nga çdo detyrim ligjor dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

Për pasurinë për të cilët është bërë shënimi “Rikonfirmim”, do të rikërkohet konfirmim pranë zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në bazë të konfirmimit përfundimtar që do të jepet nga ZRPP-ja do të hartohet dhe lista përfundimtare që do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 45 973 177 (dyzet e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: Durrës

Fshati: Bushnesh

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr. pas.	Investimi Vlera në lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri					
1	Kastriot	Rroli	1332	72/21	1052081	1052081	Rikonfirmim
						1052081	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: Lezhë

Fshati: Fushë-Mamurras

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr. pas.	Arë			Truall			Investimi Vlera në lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë			
1	Petrit	Ded Stojani	1676	158/68				137	1510	206870		206870	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Dilaver	Mexhit Gjoka	1676	212/53/1							8569617	8569617	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Dilaver	Mexhit Gjoka	1676	212/52/1									+ Leje ndërtimi
4	Islam	Xhemal Aliu	1676	158/68/1							2801072	2801072	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Zef	Prendush Buqa	1676	92/19							4010637	4010637	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Islam	Beqir Goci	1676	71/17	1798	352	632896					632896	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Alfred	Aqif Basha	1676	200/2							2888338	2888338	Konfirmuar nga ZRPP-ja
8	Gjon	Bardhok Bacuku	1676	155/2	1828	352	643456					643456	Konfirmuar nga ZRPP-ja
					3626		1276352	137		206870	18269664	19752886	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: Lezhë

Fshati: Gjorm

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr. pas.	Arë			Investimi	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Vlera në lekë		
1	Haxhi Halil	Gjoka	1768	9/9/1				2324210	2324210	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Prenë Kol	Tarazhi	1768	46/15/1	923	357	329511		329511	Konfirmuar nga ZRPP-ja
					923		329511	2324210	2653721	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

Qarku: Durrës

Fshati: Thumanë

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr.pas.	Arë			Truall			Investimi	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Vlera në lekë		
1	B/P (Zene)	Rryci	3599	28/6/1	76	442	33592					33592	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Ramazan Hajdar	Muzhaqi	3599	28/8/1	126	442	55692	37	2100	77700	3726511	3859903	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Ali Hajdar	Muzhaqi	3599	28/7/1	311	442	137462	74	2100	155400		292862	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Nezir Jangozi		3599	35/31							2775697	2775697	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Hysen Sula		3599	22/25	253	442	111826					111826	Barrë hipotekore
6	Muharrem Shima		3599	22/26	125	442	55250					55250	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Ali Shima		3599	22/8/1	181	442	80002					80002	Konfirmuar nga ZRPP-ja
8	Gëzim Shima		3599	22/9/1	196	442	86632					86632	Konfirmuar nga ZRPP-ja
9	Imer Shima		3599	22/10/1	193	442	85306					85306	Konfirmuar nga ZRPP-ja
10	Ahmet Gabili		3599	35/39	250	442	110500					110500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
11	B/P Dika		3599	66/24	672	442	297024					297024	Konfirmuar nga ZRPP-ja
12	Besnik Dika		3599					180	2100	378000	4970443	5348443	Proces regjistrimi

13	Bajram Deliu	3599	66/18				241	2100	506100		506100	Konfirmuar nga ZRPP-ja
14	Xhemal Jangozi	3599	89/17	341	442	150722					150722	Konfirmuar nga ZRPP-ja
15	Idriz Jangozi	3599	89/18	388	442	171496					171496	Konfirmuar nga ZRPP-ja
16	Hasan Mana	3599	89/19	357	442	157794					157794	Konfirmuar nga ZRPP-ja
17	Muharrem Mana	3599	89/20	152	442	67184					67184	Konfirmuar nga ZRPP-ja
18	Xhemal Mirdita	3599	89/22	363	442	160446					160446	Konfirmuar nga ZRPP-ja
19	Petrit Jangozi	3599	89/5	136	442	60112					60112	Konfirmuar nga ZRPP-ja
20	Ram Jangozi	3599	89/6	338	442	149396					149396	Konfirmuar nga ZRPP-ja
21	Agim Jangozi	3599	89/7	101	442	44642					44642	Konfirmuar nga ZRPP-ja
22	Bashkim Jangozi	3599	89/8	166	442	73372					73372	Konfirmuar nga ZRPP-ja
23	Albert Gabili	3599	89/27	242	442	106964						Konfirmuar nga ZRPP-ja (Investim me leje ndërtimi)
24	Albert Gabili	3599	89/28				247	2100	518700	4340570	4966234	Konfirmuar nga ZRPP-ja
25	Idriz Jangozi	3599	89/10	426	442	188292					188292	Konfirmuar nga ZRPP-ja
26	Xhelal Keqi	3599	89/15	314	442	138788					138788	Konfirmuar nga ZRPP-ja
27	Vesel Jangozi	3599	89/16	594	442	262548					262548	Konfirmuar nga ZRPP-ja
28	Përparim Xheke Bushi	3599	87/21	179	442	79118				858412	937530	Konfirmuar nga ZRPP-ja +Leje ndërtimi
29	Gëzim Fresku	3599	87/19	341	442	150722					150722	Konfirmuar nga ZRPP-ja
30	Hajrie Hajdar Fresku	3599	87/18	711	442	314262					314262	Proces saktësimit
31	Xhemali Aliu	3599	87/13	1986	442	877812					877812	Konfirmuar nga ZRPP-ja
				9518		4206956	779		1635900	16671633	22514489	

KËRKESË
Nr.138/1, datë 18.1.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Kashar-Rinas”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik””, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit arë dhe objekt. Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Rikonfirmim”, sqarojmë se nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do t’i rikërkohet ZRPP-së të konfirmojë gjenden juridike të tyre, duke iu referuar dokumenteve të pronësisë të depozituara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Kompensimi për efekt shpronësimi do të bëhet pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi pronarët e pasurive të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit për tokën arë dhe objektin është 2 381 866 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

SEGMENTI RRUGOR “QAFË KASHAR-RINAS”

Nr.	Pronari			Zona kadast.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Fshati	Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Bashkëpronarët Ypi, Alxhani, Bregasi			1669	241/1	Arë	2407	575	1,384,025	Fushë-Prezë	1,384,025	Rikonfirmim
2	Adem	Islam	Dervishi	1167		Objekt (Godina e pompave të ujit)	49.5		997,841	Bërxull	997,841	Rikonfirmim
		Totali									2,381,866	

KËRKESË
Nr.502, datë 26.1.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Himarë e Vjetër-Potam (shtesa)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Vërtetim” nga dokumenti hipotekor do të kërkohet dhe një herë rikonfirmimi përfundimtar nga zyra e regjistrimit Vlorë.

Vlera e këtij shpronësimi për sipërfaqen totale të tokës truall prej 33m² me vlerë shpronësimi prej 105 600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekësh, si dhe me një vlerë shpronësimi për objekt prej 562 387 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Oldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

**LISTA (SHITESË) EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “HIMARË E VJETËR-POTAM”**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. vërt. hip.	Lloji i pasurisë						Shënime	
						Truall			Objekte				
						Sip. M ²	Çmimi Lek/m ²	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë	Vlera totale lekë	Vërt. Kon.	Hip ZVRRPP
1	Fotaq	Llambro	Bollano	1952	232	33	3200	105600	Banesë	562387	667987		
	Totali							105600		562387	667987		

Shënim. Vlerësimi i objektit të pasqyruar në këtë listë është bërë në bazë të çmimeve të zërave të punës të konfirmuara nga EKB-ja.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr.954, datë 22.12.2010, vendos shpalljen të zhdukur të shtetasit Alket Latollari, i datëlindjes 27.1.1976, lindur dhe banues në fshatin Baçallëk të Pogradecit, si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, të atin, shtetasin Izija Latollari.

KËRKESË

Kërkuesja Tushe Likaj, e bija e Rakipit dhe e Esmas, e datëlindjes 1928, lindur dhe banuese në Elbasan, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të djalit të saj, shtetasit Maksim Likaj, i datëlindjes 31 janar 1950, lindur në Tiranë dhe banues në Elbasan.

KËRKUESJA
Tushe Likaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 2.2.2011

Doli nga shtypi më 3.2.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë